



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 763/3 Prot.

Tiranë, më 28.10.2021

V E N D I M

Nr.133, datë 28.10.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procedurës disiplinore përfunduar me masën “vërejtje” të nëpunëses ***, me detyrë “Përgjegjës i Sektorit të Inventarizimit dhe Regjistrimit të Pronave Shtetërore” në Bashkinë Cërrik.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; nenit 90/1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me disa pretendime për parregullsi në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, në procesin administrativ e masës disiplinore, të paraqitur nga nëpunësi *****, me detyrë “Përgjegjës i Sektorit të Inventarizimit dhe Regjistrimit të Pronave Shtetërore” në Bashkinë Cërrik.

Vërej se:

Nëpunësi civil ***** , nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 763 prot., datë 09.08.2021, ka ngritur disa pretendime për parregullsi të kryera ose të lejuara në procedurës disiplinore ndaj saj, që ka përfunduar me dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”.

Për efekt të kryerjes së hetimit administrativ, bazuar në nenin 16, Kreu III “Procedura paraprake”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me

vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u shqyrtua materiali shkresor që shoqëronte kërkesën e nëpunëses, si dhe në rrugë elektronike u kërkua dokumentacioni sqarues nga institucioni Bashkia Cërrrik, nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar si më poshtë:

Nëpunësja *****, është nëpunëse civile në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Inventarizimit dhe Regjistrimit të Pronave Shtetërore” në Bashkinë Cërrrik, (akti i deklarimit të statusit të nëpunësit civil nr. 409 prot., datë 22.04.2015), për rrjedhojë, bazuar në nenin 2, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, shqyrtimi i kërkesës për vlerësimin e ligjshmërisë së kësaj procedure administrative, përfshihet në juridiksionin e çështjeve që shqyrtohen prej Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Kërkesa e paraqitur përmban pretendime në lidhje me ligjshmërinë e zhvillimit të një ecurie disiplinore ndaj nëpunëses në fjalë, proces i cili është përmbyllur me urdhrin e brendshëm nr. 122, datë 07.07.2021, eprorit direkt, konfirmuar prej Kryetarit të Bashkisë Cërrrik, për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”.

Për vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë këtij procedimi disiplinor, u kërkua dokumentacioni i nevojshëm, i cili u dërgua në rrugë elektronike, si më poshtë: - Akti nr. 2129 prot., datë 29.06.2021, “Njoftim për nisjen e procedurës disiplinore për punonjësit”, të Komisionit Disiplinor; Akti 2259/1 prot., datë 19.07.2021, “Informacion bazuar në kërkesë”, drejtuar nëpunëses *****, të Komisionit Disiplinor; Urdhër për ngritjen e Komisionit Disiplinor, nr. 117 (2128 prot.,) datë 29.06.2021, të Kryetarit të Bashkisë Cërrrik, me objekt procedimi “braktisje të vendit të punës pa justifikim, gjatë gjithë orarit zyrtar”, deri në marrjen e vendimit nr. 06 (2220 prot.,) datë 06.07.2021 “Vendim”, të Komisionit të Disiplinës, “Për marrje mase disiplinore shkelje e lehtë, aktin nr. 2220 prot., datë 06.07.2021”, “Dërgim dokumentacioni”, drejtuar ankueses ***** si dhe urdhrin e brendshëm për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, nr.122, datë 07.07.2021, të Kryetarit të Bashkisë Cërrrik). Gjithashtu Njësia e Përgjegjëse e Bashkisë Cërrrik, ka vënë në dispozicion, një kopje të kallëzimit penal nr. 2064 prot., datë 23.06.2021, kundër ankueses *****, me objekt, “Prishja e qetësisë publike”, parashikuar nga neni 274 të Kodit Penal dhe neni 150 “Shkatërrim i pronës publike”.

Nga shqyrtimi dokumentacionit të lartpërmendur konstatohet se:

Komisioni i Disiplinës, ngritur me urdhrin nr. 117 (2128 prot.,) datë 29.06.2021, të Kryetarit të Bashkisë Cërrrik “Për Ngritjen e Komisionit Disiplinor”, për shqyrtimin e shkeljes disiplinore “Braktisje të vendit të punës, pa justifikim gjatë gjithë orarit zyrtar” nga ana e nëpunëses *****, rezulton se ka përbërje të rregullt, sipas përcaktimit të pikës 2, të kreut I, “Organet disiplinore”, të vendimit nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të

Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, i ndryshuar.

Në përbërjen e këtij komisioni mungon pjesëmarrja e nëpunësit më të lartë civil, që është Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Cërrik, pasi ai nëpërmjet kërkesës së tij, regjistruar me nr.1455/1 prot., datë 14.06.2021, drejtuar Kryetarit të kësaj bashkie, ka deklaruar pamundësinë për të marrë pjesë në përbërjen e Komisionit të Disiplinës për shkak se është person i përfshirë në procesin penal nr. 2064 prot., datë 23.06.2021, kundër ankueses ***** , me objekt, “Prishja e qetësisë publike”, parashikuar nga neni 274 të Kodit Penal dhe neni 150 “Shkatërrim i pronës publike”, kërkesë e cila është miratuar me aktin nr.1955/2, datë 15.06.2021, të Kryetarit të Bashkisë Cërrik.

Me shkresën nr. 2129 prot., datë 29.06.2021, “Njoftim për nisjen e procedurës disiplinore për punonjësit”, ankuesja, është njoftuar për fillimin e ecurisë disiplinore për shkelje të disiplinës në punë dhe konkretisht për mungesë të pa justifikuar në punë, parashikuar nga shkronja “1/a”, e nenit 57 pika, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në të njejtën kohë, është caktuar edhe seanca dëgjimore për shqyrtimin e shkeljes së pretenduar.

Në seancat dëgjimore të caktuara nga KD (data 06.07.2021 ora 12.00) për shqyrtimin e shkeljes disiplinore, nëpunësja në procedim është paraqitur dhe seanca e shqyrtimit të çështjes disiplinore është zhvilluar rregullisht dhe me dakortësinë e palëve, është regjistruar (kjo provohet me, procesverbalin e mbajtur në datën 06.07.2021).

Në përfundim të diskutimeve, pas analizës së dokumentacionit, shqyrtimit të provave dhe pretendimeve të ngritura nga nëpunësja ***** , Komisioni i Disiplinës në vendimin e tij nr. 06 dt. 06.07.2021, është shprehur se shkelja e pretenduar qëndron, por, duke vlerësuar se jemi para një shkelje të lehtë të disiplinës, mbështetur në pikën 1/c, të nenit 57, “Përgjegjësia për masën disiplinore”; në germën “a”, të nenit 58 “Llojet e masave disiplinore” dhe në pikën 1, të nenit 59, “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, çështja i është dërguar për kompetencë eprorit direkt.

Ky i fundit, duke e konsideruar të realizuar procedurën për njohjen e nëpunëses me objektin e shqyrtimit disiplinor dhe dëgjimin e pretendimeve të saj, në mbledhjen e Komisionit Disiplinor, ku ai ishte pjesëmarrës si epror direkt, me aktin nr. 06/1 dt. 06.07.2021 ka marrë vendim për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje” për nëpunësen *****.

Nisur nga sa më sipër, Kryetari i Bashkisë Cërrik, në kushtet e veprimit të ligjit Nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, i cili përcakton se gjithë komunikimet zyrtare me

të tretët, bëhen nëpërmjet Kryetarit të Bashkisë, me urdhrin e brendshëm, nr. 122, datë 07.07.2021, ka konfirmuar këtë masë disiplinore, e cila i është njoftuar nëpunëses me shkresën nr. 2237, datë 07.07.2021 “*Dërgohet masa disiplinore*”. Nisur nga ky arsyetim, bie edhe pretendimi se dhënia e masës disiplinore nga Kryetari i Bashkisë është një tejkalim kompetencash, që e bën aktin absolutisht të pavlefshëm. Në rastin konkret, Kryetari i Bashkisë me aktin e tij nr. 122, datë 07.07.2021, vetëm e ka konfirmuar masën e dhënë nga eprori direkt dhe i ka dhënë fuqi zyrtare, për t’ju komunikuar kujtdo që mund të shprehë interes.

Pas marrjes në dijeni të këtij vendimi, ankuesja *****, me anë të një kërkesë regjistruar me nr. 2258 prot., datë 09.07.2021, “*Ankesë, për vendimin nr. 2220 datë 06.07.2021, (për thyerjen e disiplinës në punë përsa i përket orarit të punës)*”, si dhe me shkresën nr. 2259 prot., datë 09.07.2021, “*Ankesë, kundër vendimit nr. 2235 datë 07.07.2021, për thyerjen e masës disiplinore “Vërejtje”, drejtuar Kryetarit të Bashkisë, Komisionit Disiplinor dhe Burimeve Njerëzore të Bashkisë Cërrrik, ka ngritur pretendimin se masa disiplinore është e paligjshme, pasi ndaj saj janë marrë dy masa disiplinore, një nga Komisioni i Disiplinës dhe një nga Kryetari i Bashkisë.*

Në sqarim të këtij pretendimi, konstatohet që Komisioni Disiplinor me shkresën nr.2259/1 prot., datë 19.07.2021, “*Informacion bazuar në kërkesë*”, ka sqaruar ankuesen se, Komisioni Disiplinës nuk ka marrë ndonjë masë disiplinore ndaj nëpunëses ***** , por në bazë të legjislacionit të shërbimit civil, ja ka deleguar shqyrtimin e rastit eprorit direkt, vendimi i të cilit është zyrtarizuar më pas edhe nga Kryetari i Bashkisë.

Nga gjithë sa u parashtua më sipër, nisur nga përmbajtja e dokumentacionit në të cilat materializohet procedura disiplinore, arrihet në konkluzionin se, si nga pikëpamja procedurale ashtu dhe ajo materiale, janë respektuar të gjitha kërkesat e ligjit, duke filluar nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore, vënies në dijeni për këtë fakt, të personit që pretendohet se ka kryer shkeljen, dëgjimin e thënieve të saj dhe administrimin e provave materiale të nevojshme, deri në marrjen e aktit nga eprori direkt dhe konfirmimit të tij nga Kryetari i Bashkisë Cërrrik.

Për këto arsye:

Në zbatim të nenit 15 pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, neneve 54 e 55, pikave “d” dhe “dh” të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*” dhe neneve 16, pika 6 dhe 34, të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë:

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, filluar në bazë të kërkesës me nr. 763 prot., datë 09.08.2021, të dërguar prej nëpunëses *****, me objekt verifikimin e pretendimeve për parregullsi të kryera apo të lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, në lidhje me procedurës disiplinore, që ka përfunduar me vendimin nr. 06 (2220 prot.) datë 06.07.2021, të Komisionit të Disiplinës dhe arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohet për këtë vendim Bashkinë Cërrik dhe kërkuesja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha